



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA PËRMET
KOORDINATORI PËR KONSULTIMIN PUBLIK

Nr. _____ Prot

Datë 15/05/2024

PROCES VERBAL

**Konsultimi për Draft Planin Lokal të Menaxhimit të Integruar të Mbetjeve të Ngurta
Urbane 2024-2029**

Vendi : Qendra Kulturore Multifunkionale, Përmet

Ora : 11:00

Tema e konsultimit : Draft Plani i Menaxhimit të Integruar të Mbetjeve të Ngurta 2024-2029.

I mbajtur sot më datë 15 Maj në sallën e konferencës pranë Qendrës Kulturore Multifunkionale. Të pranishëm në këtë takim janë : Specialisti i Shërbimeve Publike z.Arian Jaupi i cili njëkohësisht do të prezantojë më në detaje gjithë planin për menaxhimin e ketyre mbetjeve, gjithashtu prezent janë administratorët e njësive përbërëse të Bashkisë Përmet, kryepleqtë e fshatrave, punonjës të Bashkisë Përmet dhe njësive si dhe banorë të qytetit dhe fshatrave.

Takimin e hapi z.Arian Jaupi, i cili fillimisht falenderoi gjithë pjesëmarrësit e pranishëm në sallë dhe kërkoi nga ana e tyre bashkëpunim dhe angazhim në vazhdim për këtë proces mjaft të rëndësishëm si për qytetin ashtu dhe për zonat përreth.

Më pas ai vijoi me prezantimin e draft planit të hartuar nga Bashkia Përmet, impaktin e tij në përmirësimin e jetës së banorëve. Gjithashtu foli reth menyrës së menaxhimit të mbetjeve të ndryshme, shtimin e kontenierëve si në qytet ashtu edhe në fshat. Ai u tregoi të pranishmëve për skenarët e mundshëm gjatë viteve të ardhshëm dhe theksoi faktin se duhet të punojmë me seriozitet dhe përkushtim për të realizuar skenarin më të mirë të mundshëm.

Pas përfundimit të prezantimit filloi diskutimi më të pranishmit që paraqitën kërkesat e tyre si më poshtë :

Kryeplaku i fshatit Lipë kërkoi që kontenierët e rinj të jenë të pajisur me kapak në mënyrë që mbetjet të mos përhapën jashtë.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA PËRMET
KOORDINATORI PËR KONSULTIMIN PUBLIK

Kryeplaku i fshatit Qilarisht shprehu nevojën për 4 kosha të rinj dhe ndërgjegjësimit të banorëve për hedhjen e mbeturinave.

Kryeplaku i fshatit Petran kërkoi pastrim më të shpeshtë të kontenierëve të fshatit.

Administratori i Njesisë Frashër foli reth vështirësive që ka zona e tij për shkak të terrenit malor dhe kërkoi ndihmën e Bashkisë dhe organeve kompetente për të patur të njëjtin shërbim si zonat e tjera.

Kryeplaku i fshatit Piskovë kërkoi kontenierë të veçantë për të gjitha llojet e mbetjeve.

Pasi dëgjoi me vëmendje të gjitha problematikat e të pranishmëve, z.Arian Jaupi shprehu gatishmërinë për të bashkëpunuar me banorët për çdo problem si dhe u garantoj atyre se nga ana e tyre është bërë dhe do të bëhet gjithmonë maksimumi për të patur një ambient sa më pastër.

Konceptoi:

Koordinatori i Konsultimit Publik

Albion Naska

SEKRETARI PËRGJITHSHËM

Denisa DURO



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA PËRMET
KOORDINATORI PËR KONSULTIMIN PUBLIK

Foto nga takimi:





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA PËRMET
KOORDINATORI PËR KONSULTIMIN PUBLIK

